

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 3646 REP.
NR. 1178 KOL.



MARRËVESHJE SIGURUESE

Sot më datë 21/11/2017, përpara meje, Noteres Zyrtarë Haxho anetare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me Zyrë Noteriale në Tiranë, Blv. "Bajram Curri", u paraqitën palët si më poshtë:

BARRËDHËNËSI: "GJO –SPA POWER" SHPK regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit me date 20.05.2008 me Numer Unik të Identifikimit (NIPT) K87920201S, me seli tek Kthesa e Kamzes, pallati perballe Hygeia, kt. 4, Tirane, perfaqesuar nga z. **Silvio Allamandi**, shtetas italian, lindur me 17.04.1960, mbajtes i pasaportes me nr. AA 2211301, ne cilesine e Administratorit, autorizuar me Vendimin e Asamblese se Ortakeve date 21.11.2017 (më poshtë referuar si "Barrëdhënësi").

dhe,

BARRËMARRËSI: "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA, me Numër Unik të Identifikimit (NIPT) J81817006P, regjistruar me Vendim nr. 19460, datë 19.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Rr. Ismail Qemali, nr. 27, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar prej **Zj. Ermenita Harasani**, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me 03.03.1971, identifikuar me nr personal H15303195N, ne cilesine e perfaqesuesit te Bankes nga **Zj. Jona Khanaj**, shtetase shqiptare, lindur ne Korçe, me 29.09.1987, identifikuar me nr. personal I75929052S, ne cilesine e perfaqesuesve te Bankes (më poshtë referuar si "Barrëmarrësi").

me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilëve, unë noterja jam e sigurt, të cilët më deklaruan se:

Meqënëse:

- A. Barrëmarrësi në cilësinë e Kredidhënësit ka lidhur me Kredimarrës: "GJO SPA POWER" SHPK (këtu e më poshtë referuar si "Kredimarrësi") Kontratën e Kredisë me Kufi nr. 1565 rep./ nr. 478 kol., datë 10.05.2013 (këtu e më poshtë referuar si "Kontrata e Kredisë"), me shumë principali **LEKE 140,000,000** (njqind e dyzete milion) (këtu e më poshte referuar si "Principali");
- B. Barrëmarrësi në cilësinë e Kredidhënësit ka lidhur me Kredimarrës: "GJO SPA POWER" SHPK (këtu e më poshtë referuar si "Kredimarrësi") Kontratën e Kredisë Bankare nr. 3560 rep./ nr. 1618 kol., datë 23.10.2015 (këtu e më poshtë referuar si "Kontrata e Kredisë"), me shumë principali **EURO 4,061,010** (kater milion e gjashtedhjetë e nje mije e dhjetë) dhe **LEKE 274,298,902** (dyqind e shtatedhjetë e kater milione e dyqind e nentedhjetë e tete mije e nenteqind e dy) (këtu e më poshte referuar si "Principali");
- C. Për qëllime të garantimit të shlyerjes së detyrimeve që lindin për 'Kredimarrësin' nga 'Kontrata e Kredisë', kërkohet barrë siguroese në favor të Barrëmarrësit mbi kolateralin – objekt të kësaj marrëveshje siguroese;

Atëherë,

Palet, me vullnet të lirë dhe të plotë, bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Siguruese me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Neni 1 - Përkufizime

1.1 Kudo, ku përdoren në këtë Marrëveshje Siguruese, dhe vetëm nëse shprehimisht parashikohet ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- “*Kolateral*” – nënkupton pasurinë e luajtshme (të prekshme apo të paprekshme), objekt i kësaj Marrëveshje Siguruese. Kolaterali mund të ekzistojë ose mund të krijohet në të ardhmen dhe nuk kufizohet vetëm me pasuritë e luajtshme mbi të cilat Barrëdhënësi ka pronësinë apo një të drejtë të tashme. Kolaterali mund të ndodhet kudo, brenda apo jashtë Shqipërisë, dhe përfshin edhe të ardhurat kolateral. Përshkrimi i Kolateralit jepet në nenin 2.1 të kësaj Marrëveshje Siguruese.
- “*Barrë Siguruese*” – nënkupton të drejtën reale mbi ‘*Kolateralin*’, nëpërmjet se cilës sigurohet përmbushja e detyrimeve të rrjedhura për ‘*Kredimarrësin*’ nga ‘*Kontrata e Kredisë*’.
- “*Detyrime të Siguruara*” – nënkupton detyrimin, që ka ‘*Kredimarrësi*’ për të përmbushur të gjitha detyrimet sipas ‘*Kontratës së Kredisë*’, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në pagimin e shumës totale të ‘*Principalit*’, interesave dhe penaliteteve deri në ditën e shlyerjes totale të të gjitha detyrimeve të ‘*Kredimarrësit*’, së bashku me çdo shumë tjetër sipas ‘*Kontratës së Kredisë*’, si dhe pagimin e çdo shpërblimi, shpenzimi, ose pagesa të tjera të lidhura me ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve të ‘*Kredimarrësit*’ sipas ‘*Kontratës së Kredisë*’ dhe Legjislacionit Shqiptar.

Neni 2 - Barra Siguruese

2.1. Me qëllim që të sigurojë ekzekutimin e plotë të ‘*Detyrimeve të Siguruara*’ të rrjedhura për ‘*Kredimarrësin*’ nga ‘*Kontrata e Kredisë*’, ‘*Barrëdhënësi*’, nëpërmjet kësaj Marrëveshje Siguruese, vendos në favor të ‘*Barrëmarrësit*’, ‘*Barrë Siguruese*’ mbi ‘*Kolateralin*’ e përshkruar më poshtë:

Te ardhurat që rrjedhin nga Kontrata me nr. 24341 Prot. date 24.10.2016 për shitblerje të Energjisë Elektrike ndërmjet OSHEE SHA dhe prodhuesve me perparësi të Energjisë Elektrike. Kjo kontratë i bashkëngjitet kësaj Marrëveshje Siguruese dhe perben pjesë perberese dhe të pandashme të saj.


2.2. ‘*Barra Siguruese*’ e krijuar sipas kësaj Marrëveshje do të jetë detyruese e do të mbetet në fuqi për ‘*Barrëdhënësin*’, pasardhësit e tij apo posedues dhe përfitues të tjerë të kolateralit, dhe do të përbëjë një garanci të panderprerë, pavarësisht nga shlyerja e pjeshme e ‘*Detyrimeve të Siguruara*’ dhe nuk do të çenohet nga ndonjë barrë, garanci apo mjet tjetër sigurimi të vendosur në favor të ‘*Barrëmarrësit*’ nga ‘*Barrëdhënësi*’ apo të tretë.

Neni 3 – Regjistrimi i Barrës Siguruese

3.1. Nëpërmjet kësaj Marrëveshje Siguruese, ‘*Barrëdhënësi*’ jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të ‘*Barrëmarrësit*’, ‘*Barra Siguruese*’ e krijuar me këtë Marrëveshje Siguruese, të regjistrohet nga ‘*Barrëmarrësi*’ me shpenzimet e ‘*Barrëdhënësit*’, në Regjistrin e Barrëve Siguruese, në përputhje me Ligjin nr. 8573, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruese”.

3.1.1. Përveç regjistrimit në Regjistrin e Barrëve Siguruese, ‘*Barrëdhënësi*’ jep miratimin e tij, që sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të ‘*Barrëmarrësit*’, ‘*Barra Siguruese*’ dhe/ose kjo ‘*Marrëveshje Siguruese*’ të regjistrohet, me shpenzimet e ‘*Barrëdhënësit*’, edhe në regjistra apo regjistrarë kompetentë, nëse në varësi të llojit të ‘*Kolateralit*’, një regjistrim i tillë është i nevojshëm sipas legjislacionit të zbatueshëm.

3.2. ‘*Barrëdhënësi*’ kupton plotësisht dhe bie dakord se nëse ‘*Barrëmarrësi*’ është ose vihet në posedim të ‘*Kolateralit*’, atëherë për efekte të preferimit kundrejt të tretëve sipas Ligjit nr. 8573, datë



18.10.1999 "Për Barrët Siguruese", barra siguruese do të konsiderohet e kompletuar edhe me anë të vendosjes së 'Barrëmarrësit' në posedim të 'Kolateralit'.

3.3. 'Barrëmarrësi' merr përsipër se do të bëjë të mundur heqjen e barrës siguruese mbi 'Kolateralin', vetëm pas përmbushjes së plotë të të gjitha 'Detyrimeve të Siguruara'.

3.4. 'Barrëdhënësi' i jep të drejtë 'Barrëmarrësit', që me shpenzimet e 'Barrëdhënësit' të tërheqë nga organet kompetente, në çdo moment dokumentacionin provues të regjistrimit të 'Barrës Siguruese', ose vërtetimet mbi gjëndjen juridike të 'Kolateralit'.

Neni 4 – Deklarime dhe Garanci të 'Barrëdhënësit'

4.1. 'Barrëdhënësi' deklaron dhe garanton 'Barrëmarrësin', se mbi 'Kolateralin' objekt të kësaj Marrëveshje Siguruese, nuk rëndon asnjë barrë siguruese (përveç sa shprehimisht parashikohet në kësaj Marrëveshje Siguruese) në lidhje me ndonjë detyrim tjetër, dhe se 'Barrëdhënësi' është titullari i vetëm i pronësisë mbi 'Kolateralin'.

4.2. 'Barrëdhënësi' merr përsipër, që deri në momentin e shlyerjes së plotë të të gjitha 'Detyrimeve të Siguruara', të mos kryejë mbi 'Kolateralin' asnjë veprim juridik barrësimi, tjetërsimi, disponimi (material apo juridik), ndarje, bashkimi, pjestimi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të 'Barrëmarrësit'.

4.3. 'Barrëdhënësi' kupton plotësisht dhe pranon që në qoftë se 'Koleralali' humbet ose dëmtohet qoftë dhe për rast faktor, në mënyrë që të mos dëmtohen të drejtat e 'Barrëmarrësit', kjo e fundit mund të kërkojë nga 'Barrëdhënësi', që t'i jepet garanci e plotë mbi sende të tjera dhe, në mungesë të saj, mund të kërkojë pagesën e menjëhershme të detyrimeve të rrjedhura nga 'Kontrata e Kredisë'. I njëjti rregullim do të jetë i zbatueshëm edhe nëse 'Barra Siguruese' humbet ose çenohet pjesërisht apo totalisht, nga ndonjë e metë juridike e titullit të pronësisë apo e statusit juridik të 'Kolateralit'.

4.4. 'Barrëdhënësi' kupton plotësisht dhe pranon që në rast të fillimit nga ana e 'Barrëmarrësit' të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm për detyrimet e 'Kredimarrësit' të rrjedhura nga 'Kontrata e Kredisë', 'Koleralali' sipas gjykimit dhe diskrecionit të vetëm të 'Barrëmarrësit' do t'i nënshtrohet procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, pavarësisht nëse kanë filluar ose jo procedurat përbarimore edhe mbi pasuritë e tjera të luajtshme apo të paluajtshme të 'Kredimarrësit', ose Dorezanësit/(ve), ose mbi pasuri tjetër të vendosur në hipotekë apo në barrë siguruese në favor të 'Barrëmarrësit' si garanci për shlyerjen e 'Detyrimeve të Siguruara'.

4.5. 'Barrëdhënësi' deklaron se kupton plotësisht, dhe bie dakord që, 'Barra Siguruese' e krijuar në bazë të kësaj Marrëveshje Siguruese, duke qënë një e drejtë reale me titullar 'Barrëmarrësin', nuk do të çenohet apo preket, pavarësisht nëse 'Barrëmarrësi' dhe 'Kredimarrësi' vendosin të ndryshojnë kushtet e 'Kontratës së Kredisë' dhe për këtë qëllim nënshkruajnë me njëra – tjetrën amendamente të 'Kontratës së Kredisë'.

4.6. 'Barrëdhënësi' deklaron se kupton plotësisht që kjo Marrëveshje Siguruese përbën titull ekzekutiv dhe se nëse ndodh një 'Rast Shkakësor' sikundër përcaktohet në 'Kontratën e Kredisë', atëherë 'Barrëmarrësi' sipas vendimit dhe diskrecionit të vetëm të tij, do të mund të fillojë kërkimin e shlyerjes së 'Detyrimeve të Siguruara' nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm të 'Kolateralit', duke u bazuar në Ligjin nr. 8573, datë 18.10.1999 "Për Barrët Siguruese", si dhe në "Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë".

Neni 5 - Detyrime të Barrëdhënësit

5.1. 'Barrëdhënësi' do të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara për të, në këtë Marrëveshje Siguruese dhe legjislacionin në fuqi, si dhe do të respektojë cdo deklaram dhe garanci të dhënë në këtë Marrëveshje Siguruese.

5.2. 'Barrëdhënësi' do të mbajë 'Kolateralin' në kushte të mira dhe do të kryejë të gjitha riparimet e nevojshme të tij, dhe nuk do të kryejë apo lejojë asnjë humbje apo dëmtim material të 'Kolateralit'.

5.3. Nëse do t'i kërkohej nga ana e 'Barrëmarrësit', 'Barrëdhënësi' do të sigurojë 'Kolateralin' në favor të 'Barrëmarrësit', për të gjithë shumën e 'Principalit' dhe për të gjithë kohëzgjatjen e 'Kontratës së Kredisë', përkundrejt çdo lloj rreziku që do t'i kërkohej nga ana e 'Barrëmarrësit'. 'Barrëdhënësi' do të mbajë të përjashtuar 'Barrëmarrësin' nga përgjegjësia për kryerjen e pagesave të shpenzimeve për sigurimin e 'Kolateralit'.

5.4. 'Barrëdhënësi' garanton 'Barrëmarrësin' lidhur me vlefshmërinë e 'Barrës Siguruese' të krijuar në favor të 'Barrëmarrësit' në bazë të kësaj Marrëveshje Siguruese, si dhe përkundrejt çdo të mete juridike që mund të çënojnë 'Barrën Siguruese'. Në këtë kuadër, 'Barrëdhënësi' detyrohet të marrë pjesë në gjykimin e cdo çështje gjyqësore në mbrojtje të interesave të 'Barrëmarrësit', dhe zgjidhë konfliktin në favor të 'Barrëmarrësit'. Në rast se 'Barrëmarrësit' i çënohet 'Barra Siguruese', qoftë pjesërisht apo edhe tërësisht, atëherë 'Barrëdhënësi' do të jetë i detyruar personalisht me të gjithë pasurinë e vet të luajtshme apo të paluajtshme, për shlyerjen e detyrimeve të 'Kredimarrësit' të rrjedhura nga 'Kontrata e Kredisë'.

5.5. Në rast se persona të tretë pretendojnë të drejta pronësie, posedimi, uzufukti, enfiteoze, apo të drejta përdorimi ose ndonjë të drejte tjetër reale, 'Barrëdhënësi' garanton se do të ruajë të pacënuar 'Barrën Siguruese' të 'Barrëmarrësit' mbi 'Kolateralin'.

5.6. 'Barrëdhënësi' do të pranojë dhe lejojë punonjësit e 'Barrëmarrësit', që me kërkesën e tyre, të inspektojnë dhe monitorojnë gjëndjen e 'Kolateralit'. Gjithashtu, 'Barrëdhënësi' bie dakord dhe pranon, që nëse do të kërkohet nga 'Barrëmarrësi' rivlerësimi i 'Kolateralit' nga ekspertë vlerësues, të lejojë kryerjen e rivlerësimit si dhe të mbulojë shpenzimet e lidhura me rivlerësimin përkundrejt ekspertit vlerësues të perzgjedhur nga 'Barrëdhënësi' nga lista e publikuar e Vlerësuesve të Jashtëm që Banka i vë në dispozicion.

Neni 6 – Të ndryshme

6.1. Çdo njoftim ose kërkesë do të konsiderohet i kryer kur bëhet me shkrim dhe dërgohet në adresat e parashikuara për palët në këtë Marrëveshje Siguruese.

6.2. Në rast se ndonjë klauzolë ose detyrim sipas kësaj Marrëveshje Siguruese do të jetë apo shpallet e pavlefshme, e kundërligjshme ose e pazbatueshme, - vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e klauzolave ose e detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Marrëveshje Siguruese, nuk do të çënohen apo ndikojnë në zbatim.

6.3. Në zbatim të nenit 127 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Vendimit nr. 67 datë 13.10.2010 "Për miratimin e Rregullores "Për përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e regjistrit të kredive në Bankën e Shqipërisë" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, 'Barrëdhënësi' nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Siguruese: (i) deklaron se i gjithë informacioni i dhënë prej tij është i saktë dhe i plotë, si dhe (ii) duke kuptuar se, të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të 'Barrëdhënësit', autorizon "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA, që për qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit të 'Kredimarrësit' për të marrë kredi; 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktore të kredisë së 'Kredimarrësit' me "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA; 3. vlerësimin e besueshmërisë së 'Kredimarrësit' së bashku me personat e tretë të lidhur me 'Kredimarrësin'; të njihet me detyrimet e 'Barrëdhënësit' ndaj bankave/degëve të bankave të huaja/subjekteve kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Regjistrit të Kredive, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, 'Barrëdhënësi' jep pëlqimin që "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA të përdorë emërin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare të 'Barrëdhënësit' që mbahen në Regjistrin e Kredive, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

6.4. Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar 'Barrëdhënësi' në mënyrë të parevokueshme autorizon "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA të transferojë dhe të trajtojë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij (më poshtë referuar si "Informacioni Konfidencial") me dhe tek Shoqëria Mëmë e saj: "Intesa Sanpaolo" S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqëria Mëmë: "Intesa Sanpaolo" S.p.A. 'Barrëdhënësi', duke kuptuar se të dhënat e tij personale dhe financiare do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar dhe profesional, si dhe duke marrë në konsideratë gjithashtu se "Intesa Sanpaolo Bank Albania" SHA dhe Shoqëria Mëmë e saj: "Intesa

Sanpaolo” S.p.A kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e sigurt të të dhënave të ‘Barrëdhënësit’, autorizon “Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, - që për qëllimet që përfshijnë: 1. vlerësimin e aplikimit të ‘Kredimarrësit’ për kredi; dhe/ose 2. vlerësimin e rrezikut të kredisë gjatë të gjithë afatit të marrëveshjes kontraktore të kredisë së ‘Kredimarrësit’ me “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SHA; dhe/ose 3. vlerësimin e besueshmërisë së ‘Kredimarrësit’ së bashku me palët e treta të lidhura me ‘Kredimarrësit’; dhe/ose 4. mbikëqyrja e konsoliduar nga Shoqëria Mëmë: “Intesa Sanpaolo” S.p.A [duke përfshirë por pa u kufizuar tek qëllimet e konsolidimit të pozicioneve të mëposhtme: (a) kapitalin rregullator, (b) mjaftueshmërinë e kapitalit, (c) ekspozimi i rrezikut, (d) pozicionet e hapura të këmbimeve valutore, (e) investimet në institucionet kapitale dhe jo kapitale]; dhe/ose 5. monitorimi dhe procesi i administrimit të rreziqeve të bankës dhe rrezikut të Grupit Bankar Intesa Sanpaolo, ose me konsolidimin e pozicioneve që parashikohen në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar - për të transferuar dhe trajtuar të gjitha të dhënat personale dhe financiare me dhe tek Shoqëria Mëmë e saj: “Intesa Sanpaolo” S.p.A, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqëria Mëmë: “Intesa Sanpaolo” S.p.A. Në përputhje me sa më sipër, ‘Barrëdhënësi’ autorizon “Intesa Sanpaolo” S.p.A të ketë akses, të përdorë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare që zotëron “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SHA dhe/ose kjo e fundit merr në zotërim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu pranohet se i gjithë Informacioni Konfidencial do të mbrohet përpara keqpërdorimit, dëmtimit, shkatërrimit, zhvlerësimit, humbjes dhe vjedhjes dhe “Intesa Sanpaolo” S.p.A nuk do të përdorë Informacionin Konfidencial për asnjë qëllim tjetër përveçse për qëllimet që përcaktohen më sipër, si dhe nuk do t’i zbulohen, vihen në dispozicion, publikohen ose përhapen palëve të treta. “Intesa Sanpaolo” S.p.A do të sigurojë që vetëm personat përgjegjës (duke përfshirë Nën-kontraktorët dhe Filialet) të cilëve u zbulohet informacioni në funksion të përmbushjes së qëllimeve të parashikuara më sipër, do të kenë akses të Informacionit Konfidencial. Informacioni konfidencial mund të zbulohet deri në masën e parashikuar me ligj gjykatës, zyrës së prokurorisë dhe organeve të tjera kompetente që gëzojnë këtë të drejtë në bazë të ligjit dhe rregulloreve të zbatueshme, një gjykatësi ose çdo autoriteti rregullator. “Intesa Sanpaolo Bank Albania” SHA dhe Shoqëria Mëmë e saj: “Intesa Sanpaolo” S.p.A do të sigurojnë respektimin nga ana e Personelit të saj (duke përfshirë Nënkontraktorët dhe Filialet) të detyrimeve për konfidencialitetin e marrë përsipër.

6.5. Gjithashtu, përveç sa përcaktohet në nenin 6.4, ‘Barrëdhënësi’ në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (duke përfshirë ketu por duke mos u kufizuar tek neni 6 pika 1 shkronja “a”, nenin 8, si dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nën-ligjore të aplikueshme) dhe Ligjit Nr. 9662 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar jep pëlqimin dhe autorizon Bankën, të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë të dhënat personale dhe financiare të tij, me dhe tek cdo subjekt i treta, i cili kryen një ose disa shërbime në emër dhe për llogari të Bankës (duke përfshirë edhe nën-kontraktorët e tyre), me vendndodhje si brënda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të kontraktuar nga Banka sipas diskrecionit të Bankës, për qëllime të ushtrimit, monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm, të aktivitetit të saj bankar dhe financiar; megjithatë duke parashikuar shprehimisht ketu se subjektet e tretë (duke përfshirë edhe nën-kontraktorët e tyre) do të jenë gjithashtu përgjegjës dhe kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe financiare të ‘Barrëdhënësi’.

6.5.1 Banka garanton ‘Barrëdhënësin’ se përpunimi i të dhënave do të menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale dhe do të bëhet në përputhje me menyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

6.5.2 ‘Barrëdhënësi’ nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Bankës, ka të drejtë (i) të marrë në çdo kohë konfirmimin për përpunimin ose jo të të dhënave personale të tij, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale të ‘Barrëdhënësit’; (ii) të njihet me përmbajtjen dhe burimin e të dhënave personale të përpunuara nga Banka; (iii) të kërkojë korigjimin ose fshirjen e tyre kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar; (iv) të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij. ‘Barrëdhënësi’ gëzon të drejtën e ankimit në rast se pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm në lidhje me të dhënat personale. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, Banka nuk do të kryejë ndryshime në të dhënat e tij personale deri në dhënien e

vendimit. 'Barrëdhënësi', të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim Bankës për dëmin e shkaktuar.

6.6. Banka ka të drejtë që të cedojë tek personat e tretë, tërësisht ose pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga 'Kontrata e Kredisë', në bazë të gjykimit dhe vendimit të saj dhe pavarësisht nëse 'Kredimarrësi' ndodhet ose jo në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore. 'Barrëdhënësi' deklaron se kupton dhe pranon që Banka do të mund të disponojë lirisht dhe të kalojë 'Kontratën e Kredisë' dhe rrjedhimisht dhe kete Kontrate, me ose pa shpërblim, më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate 'Barrëdhënësi' bie dakord të pranojë dhe ekzekutojë të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate kundrejt palës së tretë, në përputhje me Marrëveshjen e Cedimit apo Kalimit të Kontratës së Kredisë.

Për të bërë të mundur realizimin e këtij cedimi të drejtash apo kalimi kontrate, sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, 'Barrëdhënësi' në mënyrë të përvokueshme autorizon Bankën t'i japë të dhënat personale dhe financiare të tij, të nevojshme përpara, gjatë dhe pas lidhjes së Marrëveshjes së Cedimit (duke përfshirë edhe, por pa qënë i kufizuar në shitjen apo në një formë tjetër të disponimit të kontratës) kujtdo pale me të cilën Banka dëshiron të hyjë në këtë marrëdhënie cedimi apo kalimi kontrate.


6.6.1 Përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj apo në aktet nën-ligjore të zbatueshme, 'Barrëdhënësi' nëpërmjet kësaj Kontrate, jep pëlqimin në mënyrë të përvokueshme se në rast mospërbushje të detyrimeve kontraktore sipas 'Kontratës së Kredisë' nga ana e 'Kredimarrësit', Banka në kuadër të rekuperimit të kredisë, pavarësisht nëse ka ndërmarrë ose jo veprimet proceduriale përbarimore, do të ketë të drejtë të përhapë, transferojë dhe/ose të përpunojë të dhënat personale dhe financiare të 'Barrëdhënësi', me cdo subjekt tjetër, në kuadër të vlerësimit paraprak apo realizimit të kalimit të Kontratës së Kredisë dhe rrjedhimisht dhe këtë Kontratë (nëpërmjet shitjes apo forma të tjera të disponimit, me ose pa shpërblim), më vete ose si pjesë të një portofoli kredish, tek subjekte të tretë, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Neni 7- Legjislacioni qe zbatohet

Kjo Marrëveshje Siguruese është objekt dhe është hartuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim i lindur ose i lidhur me këtë Marrëveshje Siguruese do të shqyrtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Kjo Marrëveshje Siguruese u hartua në 3 (tre) kopje të njëjta e të barazvlefshme në gjuhën shqipe. Secila nga palët mban nga një kopje; dhe një kopje e Marrëveshjes Siguruese ruhet në Zyrën Noteriale. Interpretimi i kushteve kontraktore do të bëhet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe qëllimin e palëve për të lidhur këtë Marrëveshje Siguruese.

Unë Noterja, ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Marrëveshje Siguruese dhe i njoha palët me efektet ligjore të saj, ato më deklaruan se e kuptojnë atë, konstatova se palët e gjejnë Marrëveshjen Siguruese në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe te plotë, dhe Unë Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.



BARRËMARRËSI

“INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA

Përfaqesuar nga:

Ermenita Harasani

Ermenita Harasani
Jona Khanaj

Jona Khanaj



Perkthyes:

Alma KAPE

Alma Kape

BARRËDHËNËSI

“GJO –SPA POWER” SHPK

Përfaqesuar nga:

Simon Arana

Simon Arana



NOTERE



Enkeleida Hoxha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTËRËVE TIRANË

Nr. 1446 Rep

Nr. 398 Kol

11



VENDIM

I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË

GJO-SPA POWER SH.P.K

Në Tiranë, sot më 21/11/2017, në orën 10:00, përpara meje Noterit, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, është mbledhur asambleja e përgjithshme e ortakëve të "Gjo-Spa Power" Sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me numër identifikimi (NIPT) K87920201S, me seli në adresën: Kashar, Kthesa e Kamzës, Pallati përballë spitalit Hygeia, Kati 4, Tiranë, Shqipëri (më poshtë referuar "Shoqëria"), për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Regjistrimi i barrëve siguroese dhe pengut në favor të Bankës mbi të gjitha shumat e arkëtueshme të Gjo-Spa Power Sh.p.k që vijnë nga OSHEE Sh.a nga shitjet e energjisë elektrike, si garanci për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshjet e Huave:
 - (i) Hua bankare nr. 3560 Rep./ nr. 1618 Kol. nënshkruar më 23.10.2015 me prim në shumat 4,061,010 EUR (katër milion e gjashtëdhjetë e një mijë e dhjetë euro) dhe 274,298,902 LEK (dyqind shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dy lekë);
 - (ii) Hua bankare me nr. 1565 Rep./ nr. 478 Kol. nënshkruar më 10.05.2013 me prim në shumën 140,000,000 LEK (një qind e dyzetë milion lekë);
2. Miratimi i zgjatjes së afatit të maturimit të marrëveshjes ekzistuese të kredisë me kufi me 1565 Rep./ nr. 478 Kol. datë 10.05.2013, në shumë prej 140,000,000 LEK deri më 03.10.2018.
3. Autorizimi i administratorit të Gjo-Spa Power Sh.p.k., Z. Silvio Allamandi:
 - (i) të nënshkruajë me Bankën marrëveshjen për barrë siguroese dhe pengun mbi të gjitha shumat e arkëtueshme të Shoqërisë që vijnë nga OSHEE Sh.a.
 - (ii) të nënshkruajë me Bankën ndryshimin përkatës të Marrëveshjes së Kredisë me Kufi me nr. 1565 Rep./ nr. 478 Kol., datë 10.05.2013;
 - (iii) të ndërmarrë, në emër dhe për llogari të Gjo-Spa Power Sh.p.k, çdo veprim dhe të nënshkruajë të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet në lidhje me realizimin e vendimeve të mësipërme.
4. Të ndryshme.

Në mbledhje janë të pranishëm:

- 1) "Inisiativa Hidroelektrike Shqiptare" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, mbajtur në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me numër identifikimi K92027006A, me seli në adresën: Kashar, Kthesa e Kamzës, Pallati përballë spitalit Hygeia, Kati 4, Tiranë, Shqipëri, zotëruese e 80 kuotave, që përfaqësojnë 80% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, përfaqësuar nga Z. Davide Degiovanni, bazuar në vendimin e Asamblesë së Ortakëve, datë 10/11/ 2017;
- 2) "Armemil" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, mbajtur në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me numër identifikimi J87730208C, me seli në adresën: Lagja 2, Kukës, Shqipëri, zotëruese e 10 kuotave, që përfaqësojnë 10% të kapitalit themeltar përfaqësuar nga Z. Kujtim Gjoka, bazuar në vendimin e Ortakut të Vetëm të shoqërisë, data 20/11/ 2017;

Shoqëria "Fatjon" Sh.p.k. mungon në asamble pasi ka komunikuar paraprakisht që nuk do të jete prezent në asamblesë e shoqërisë "Gjo-Spa Power" shpk;

Z. Silvio Allamandi emërohet Kryetar i Asamblesë. Kryetari deklaron se Asambleja është mbledhur rregullisht duke qenë se në të janë të pranishëm të gjithë ortakët e Shoqërisë.

Në vijim të diskutimeve, Asambleja me unanimitet vendosi:

VENDIMI I PARË

Të miratojë regjistrimin e barrëve siguruese dhe pengut në favor të Bankës mbi të gjitha shumat e arkëtueshme të Gjo-Spa Power Sh.p.k që vijnë nga OSHEE Sh.a nga shitjet e energjisë elektrike, si garanci për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshjet e Huave:

1. Hua bankare nr. 3560 Rep./ nr. 1618 Kol. nënshkruar më 23.10.2015 me prim në shumat 4,061,010 EUR (katër milion e gjashtëdhjetë e një mijë e dhjetë euro) dhe 274,298,902 LEK (dyqind shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dy lekë);
2. Hua bankare me nr. 1565 Rep./ nr. 478 Kol. nënshkruar më 10.05.2013 me prim në shumën 140,000,000 (një qind e dyzetë milion lekë);

VENDIMI I DYTË

Të miratojë zgjatjen e afatit të maturimit të marrëveshjes ekzistuese të kredisë me kufi me 1565 Rep./ nr. 478 Kol datë 10.05.2013, në shumë prej 140,000,000 LEK deri më 03.10.2018.

VENDIMI I TRETË

Të autorizojë administratorin e Gjo-Spa Power Sh.p.k., Z. Silvio Allamandi:

- (i) Të nënshkruajë me Bankën marrëveshjen për barrë siguruese dhe pengut mbi të gjitha shumat e arkëtueshme të Shoqërisë që vijnë nga OSHEE Sh.a.



- (iii) të ndërmarrë në emër dhe për llogarit të Gjo-Spa Power Sh.p.k., çdo veprim të nevojshëm dhe të zbatojë të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet e nevojshme për përmbushjen e vendimeve të mësipërme.

VENDIMI I KATËRT

Të regjistrohet vendimi në regjistrin e Vendimeve të Asamblesë së Ortakëve dhe të autorizohet Znj. Drilona Imeraj, me kartë identiteti nr. I75822060R që të nënshkruajë dhe dorëzojë të gjitha dokumentet e nevojshme për paraqitjen dhe regjistrimin e mundshëm të këtij vendimi dhe dokumenteve të tjerë në lidhje me të në Regjistrin Tregtar, si dhe pranë çdo autoriteti tjetër publik ku paraqitja dhe regjistrimi është i kërkuar me ligj.

Duke qenë se nuk ka më çështje për t'u diskutuar asambleja konsiderohet e mbyllur.

Unë i nënshkruari Noteri në praninë dhe asistencë e përkthyesit Glodiola Duli, u lexoj më zë të lartë përmbajtjen e këtij akti të pranishmëve, të cilët më deklarojnë se e kuptojnë përmbajtjen e këtij akti, i cili është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre dhe e nënshkruajnë atë në praninë time dhe unë, Noteri e vërtetoj aktin në përputhje me ligjin në fuqi.

ORTAKËT

Inisiativa Hidroelektrike

Shqiptare Shpk.

DAVIDE DECI OVANNI

David Decis

Fatjon Shpk.

Armemil Shpk

Armemil

Përkthyes

Glodiola Duli

NOTER

Luigj Gjok

REPUBLIC OF ALBANIA
NOTARIES CHAMBER OF TIRANA

Rep. No. 1446
Coll. No. 348



RESOLUTION
OF THE GENERAL MEETING OF THE SHAREHOLDERS OF THE COMPANY
GJO-SPA POWER SH.P.K

In Tirana, this day 21/11/2017, at 10:00, in front of me, Notary Public of Tirana Chamber of Notaries, is convened the Shareholders' General Assembly of Gjo-Spa Power Sh.p.k., a company registered with the Albanian Commercial Register, upon identification number K87920201S, having the legal seat at the address: Kashar, Kthesa e Kamzes, Pallati perballe spitalit Hygeia, Kati 4, Tirana, Albania, (hereinafter referred to as the "Company"), in order to discuss and resolve on the following agenda:

1. To approve the registration in favour of the Bank, a securing charge, pledge on receivable of Gjo-Spa Power Sh.p.k. from OSHEE Sh.a. deriving from sales of electricity as a security for the fulfilment of obligations arising from following Loan Agreements:
 - (i) Bank a loan Rep. no. 3560, Col. no. 1618, signed on 23.10.2015 with principal amounts of EUR 4,061,010 (four million sixty-one hundred and ten Euros) and ALL 274,298,902 (two hundred seventy-four million two hundred ninety-eight thousand and nine hundred and two Albanian Lek);
 - (ii) Bank a loan Rep. no. 1565, Col. no. 478, signed on 10.05.2013 with principal amounts of ALL 140,000,000 (one hundred forty million Albanian Lek);
2. To approve the maturity extension of the existing Overdraft Agreement Rep. no. 1565, Col. no. 478, dated 10.05.2013 of ALL 140,000,000 until 03.10.2018;
3. To authorize the administrator of Gjo-Spa Power Sh.p.k., Mr. Silvio Allamandi to:
 - (i) To sign with the Bank the respective securing charge and pledge agreement over all receivables of the Company from OSHEE Sh.a.;
